

BANDA KOMBËTARE "VATRA": NJË HISTORI UNIKE
SHQIPTARO-AMERIKANE

Vasil S. Tole

Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë (2020, ISBN 9789928237897)

Libri paraqet si një kronikë e detajuar historike e bandës "Vatra", përgjatë ekzistencës së saj aktive gati 10-vjeçare mes Shqipërisë dhe ShBA-së. Gjithashtu vjen edhe vijueshmëria e saj si bandë mbretërore deri në

mbarim të Luftës së Dytë Botërore. Kjo kronikë është ndërtuar mbi bazën e dokumenteve arkivore, rrëfimeve gojore të anëtarëve të saj dhe dëshmitarëve bashkëkohës. Në dy kapitujt e parë, autori bën një

përshkrim të përgjithshëm të jetës muzikore të diasporës shqiptare në Amerikë, përshkrim i cili lë të kuptohet se themelimi i kësaj bande nuk ishte një akt i izoluar, por pjesë e një aktiviteti muzikor që diaspora kishte ndërmarrë në këtë kuadër dhe ku spikasin banda e mandolinata të ndryshme, por edhe emra të përveçëm si ai i Ajdin Asllan Leskovikut. Në këtë suazë përmendet edhe themelimi i të parës etiketë diskografike shqiptare me emrin “Albanian Phonographic Records, nga Spiridon Ilo. Më tej – në kapitujt 3 dhe 4 - vijohet me ardhjen e “Vatrës” në Shqipëri dhe përshkrimin e rolit aktiv të saj gjatë një viti jashtëzakonisht delikat për Shqipërinë, viti 1920, ndër pikat kulmore të të cilit ishte lufta e Vlorës. Një tjetër moment, po aq i rëndësishëm është aktiviteti që banda “Vatra” zhvilloi në vijim në qytetin e Korçës, përmes Shoqërisë së Arteve të Bukura, që funksionoi si një qendër arti dhe që la gjurmë në jetën artistike të Korçës në gjysmën e parë të viteve '20-të.

Ndërsa studiues si Zana Shuteriqi, Eno Koço apo Jakup Mato e kanë trajtuar historinë e bandës “Vatra”, si dhe aktivitetin

e drejtuesit të saj, Thoma Nasi në kuadër të zhvillimeve të muzikës shqiptare, Vasil Tole ofron një lexim tjetër për historinë e kësaj bande, në lenten e lidhjeve shqiptaro-amerikane. Këtyre iu ka kushtuar një kapitull më vete (të gjashtin). Gjithsesi, matanë pjesës shtetërore e diplomatike, kjo marrëdhënie shfaqet sidomos përmes rolit aktiv të diasporës nga një anë dhe bashkëpunimit dhe mbështetjes së vazhdueshme që Thoma Nasi, drejtuesi i bandës “Vatra” arriti të siguronte me organizata të tilla si Kryqi i kuq, apo Young Christian Organizations. Faksimilet e letërkëmbimeve që jepen në libër dhe materialet dokumentare nxjerrin në pah jo vetëm një muzikant, por edhe një agjent kulturor me një program vizionar sa i takon ngritjes së një infrastrukture institucionale të muzikës.

Më tej, vijohet me dy kapituj mbi kontributin e Thoma Nasit në Shqipëri dhe më pas në Amerikë. Është për t'u vënë në pah aftësia organizative e Nasit edhe në Amerikë në drejtim të muzikës. Gjithashtu, ndjekim edhe ecurinë e mëtejshme të bandës, e cila filloi të inkuadrohet

brenda këtij kuadri institucional që po ngrihej nga Ahmet Zogu. Vëmendje autori i ka kushtuar gjithashtu edhe legjislacionit përkatës mbi bandën, dëshmi kjo e synimeve për t'i dhënë muzikës një status institucional në mbretërinë shqiptare.

Ftesa që bën Vasil Tole përmes kësaj kronike historike mbi bandën “Vatra” është që përmes muzikës të kuptojmë historinë e Shqipërisë në gjysmën e parë të shekullit XX. Kjo është një periudhë e mbushur me kriza, konflikte dhe sprova të shumta, qoftë në nivelin e brendshëm të shtetit të ri shqiptar, ashtu edhe në atë të jashtëm rajonal e deri global. Dy luftërat botërore janë një lloj kornize që hap e mbyll ngjarjet e trajtuara në këtë libër.

Dhe, në gjithë këtë periudhë të mbushur me ngjarje shohim dhe dëgjojmë rolin që ka luajtur muzika në historinë e vendit. Nuk janë thjesht zhvillime muzikore në vetvete. Ato i përkasin një kuadri më të gjerë social-kulturor, i cili kështu i shtjelluar kronologjikisht hap shtegun interpretativ për një lexues të vëmendshëm. Edhe pa qenë të artikuluar specifikisht nga autori, këto ngjarje e kronika mund të konsiderohen në lanten e

aktivizmit dhe vullnetarizmit muzikor, dy dinamika thelbësore për krijimin dhe ekzistencën e bandës “Vatra”. Në një plan po aq të rëndësishëm është pjesa e patriotizmit muzikor, me të cilin është i lidhur ky lloj aktivizmi. Banda “Vatra” e artikulon më së miri si trupë muzikore dhe si repertor. Patriotizmi muzikor i saj kërkon të krijojë sensin e komunitetit, të përbashkimit të këtij në ndjenjë dhe qëllim. Ky patriotizëm muzikor gjen aplikim gjerësisht në Europë e Amerikë përgjatë gjysmës së dytë shek. XVII dhe gjatë gjysmës së parë të shek. XIX. Së fundi, kemi forma të akulturimit të muzikës perëndimore, pra të ndikimit që muzika klasike perëndimore fillon të luajë në plazmën kulturore nacionale të asaj periudhe, si etalon për civilizimin, ngritjen kulturore. Kjo prek jo vetëm repertorin që lëvron banda “Vatra”, por edhe orientimin personal muzikor që anëtarët e saj, Thoma Nasi, deri edhe vetë Ahmet Zogut kanë ndaj kulturës muzikore perëndimore. Mbi të gjitha këto modele akulturimi i kanë formësuar këtë protagonistë si shtetas modernë Shqipërisë.

Në fund, autori bën edhe një lidhje mes aktivitetit të bandës “Vatra” dhe krijimit të bandës së ushtrisë gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe që pas saj, i hap rrugë institucionalizimit të këtij

formacioni. Kësisoj, në rrjedhën e vet kronologjike, aktiviteti i bandës “Vatra” vjen si një nga sprovat e para të rëndësishme për institucionalizimin e muzikës.

Mikaela Minga